

VENDIM
Nr.609, datë 7.9.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 27.7.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUSHTET E NXJERRJES SË PULLËS POSTARE SHQIPTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.405, datë 27.7.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Pranë ministrisë, përgjegjëse për shërbimet postare, funksionon Komisioni Shtetëror i Pullës Postare Shqiptare, i cili ka në përbërje specialistë të shërbimeve postare, personalitete të njohura të shkencës, kulturës, artit, përfaqësues nga fusha e filatelistë, si dhe përfaqësues nga “Posta Shqiptare”, sha.

Anëtarët e këtij komisioni emërohen nga ministri.”.

b) Në pikën 3, emërtimi “... DPPT-në...” zëvendësohet me “... drejtorisë përgjegjëse për shërbimet postare ...”.

c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Emetimi, vënia dhe heqja nga qarkullimi i çdo emisioni të pullave postare miratohen nga drejtoria përgjegjëse për shërbimet postare.”.

ç) Kudo në vendim emërtimi ““Albaposta”, sha” zëvendësohet me “Posta Shqiptare”, sha.”.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha